REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
GRAMSH

Nr. 4462/2 prot. Gramsh më 02.11.2026

VENDIM

NR.83,Datë 30.10.2026

Për miratimin e sistemimit të pikëzimit për familjet që kërkojnë të përfitojnë nga programet sociale të strehimit(Subvencionimi i qerasë në treg të lire).

Bazuar në ligjin nr.22/2018"Për strehimin social" neni 15,48,të VKM-së nr.384, date 12.06.2019, "Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për t'u strehuar sipas njerit prej programeve sociale të strehimit dhe të afateve,proçedurave të miratimit nga organet e vetqeverisjes vendore: ,të ligjit nr.139/2015, date 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore" neni 8, pika2; neni24, pika 2,të relacionit të drejtorisë së Mbrojtjes Civile,:

VENDOSI:

I. Miratimin e sistemit të pikëzimit për familjet që kërkojnë të përfitojnë nga programet sociale të strehimit,subvencionimi i qirasë ,sipas tabelës së mëposhtme:

Formula e Pikëzimit për aplikantët në programin e strehimit social "Subvencioni qirasë"

	KRITERET E PIKËZIMIT	Pikët
1.1	**KUSHTET E STREHIMIT**	**25**
A	Nuk disponon apartament në pronësi	7
B	Banojnë në banesa në rrezik shembjeje, kanë mbelur ose rrezikojnë të mbeten të pastreha, si rezultat i fatkeqësive natyrore	5
C	Familjet ose individët që humbasin banesën e tyre, si pasojë e zhvendosjes ose zbatimit të një vendimi gjyqësor	4

Ç	Banojnë në banesa që prishen ose përjashtohen nga procesi i legalizimit, si rezultat i investimeve publike.	3
D	I pastrehë si rezultat I fatkeqësive natyrore	6
1.2	**KUSHTET FAMILJARE**	**25**
A	Familje një prindërore që kanë në ngarkim fëmijë ku perfshihen dhe vajzat nëna	7
B	Përbëhen nga familje që kanë në ngarkim persona me aftësi të kufizuar apo persona në pension .	7
C	Familjet me më shumë se katër fëmijë	6
Ç	Familje te reja ku çifti bashkëshortëve ka moshe te perbashket totale deri 60 vjeç.	5
1.3	**KUSHTET SOCIALE**	**25**
A	Ka statusin e jetimit dhe moshë deri në 30 vjeç	3
B	Ka mbetur i pastrehë për shkak të lirimit të banesës ish-pronarëve	1
C	Emigrant i rikthyer / punëtor emigrant	1
Ç	Azilkerkues	1
D	Familje e punonjësit të Policisë së Shtetit të rënë në detyrë	3
DH	Punonjës i Repartit të Ndërhyrjes së Shpejtë (FNSH) /Punonjës i RENEA-s /	1
E	Punonjës i Shpëtimit dhe i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit	1
Ë	Viktimë e dhunës në familje	1
F	Viktimë e trafikimit/viktimat e mundshme te trafikimit	1
G	Anëtar i minoritetit rom /egjiptian	2
GJ	I mitur në konflikt me ligjin	1
H	Komuniteti LGBTI	1
I	Anëtar i familjes që trajtohet me ndihmë ekonomike	2
J	Anetar I familjes me aftesi te kufizuar (PAK)	2
K	Familje vajzë-nëne	3
1.4	**KUSHTET EKONOMIKE**	**25**

II. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet kryetari i bashkisë,drejtoria e Mbrojtjes Civile si dhe sektori I Emergjencave Civile dhe Strehimit.

III. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sekretare e Këshillit

Xhulia GJINI

Kryetare e Këshillit

Luljeta DOLLANI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA GRAMSH